



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.3160/9 prot.

Datë 26.01.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 101/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Star Trade Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-88061-11-17-2023, me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 30-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK me NIPT L82729403H dhe adresë: Zharëz, Fshati Frashër, Patos, Fier.

**Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë  
Lagjja: “Kushtrimi”, Ish Parku Urban.

**Subjekte të Interesuara:**

“Star Trade Albania” SHPK me NIPT L82309028R dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ymer Kurti”, Pallati 2/1, Apartamenti 3, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**II**

## Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.11.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-88061-11-17-2023 me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

II.2. Në datën 30.11.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 07.12.2023, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Star Trade Albania” SHPK	1,767,600	lekë	kualifikuar
2. “Bregu Company” SHPK	1,883,720	lekë	kualifikuar
3. “Univers Promotion” SHPK	1,887,900	lekë	kualifikuar
4. “Biotek” SHPK	1,936,250	lekë	kualifikuar
5. “AMEL-E.Z” SHPK	1,995,540	lekë	kualifikuar
6. “Blerina Sadiku” SHPK	1,999,490	lekë	kualifikuar
7. “Bajro Bros” SHPK	1,999,490	lekë	kualifikuar
8. “ARTEO 2018” SHPK	2,095,670	lekë	kualifikuar
9. “Malvina Visoka” SHPK	2,226,800	lekë	kualifikuar
10. “Optima Communication” SHPK	2,400,000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 19.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2023/3693 dhe me nr. protokollit 3160/2023, datë 20.12.2023, e operatorit ekonomik “Bregu Company” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Star Trade Albania” SHPK, duke argumentuar si më poshtë:

*[...] Shkelje të pikës 1 Neni 97 i ligjit të prokurimit publik nr. 162 datë 23.12.2020, dhe të nenit 83 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021, e ndryshuar. për arsye se nga data e mbylljes së procesit të vlerësimit deri më sot nuk është kryer asnjë veprim brenda afateve sikundër parashikohet në legjislacion.*

*Parregullsi të procesit të vlerësimit përkatësisht pranimi dokumentacionit provues të OE Star*

*Trade Albania jashtë afateve ligjore, vonesë në publikimin e njoftimit të fituesit dhe mosvazhdimi me procesin e rivlerësimit dhe kalimit të operatorët ekonomik të kualifikuar sipas renditjes së kualifikimit.*

*Procedura ndodhej në fazën e njoftimit të renditjes së vlerësimit që prej datës 07.12.2023 duke tejkaluar çdo afat të zhvillimit të saj.*

*Autoriteti Kontraktor duhet të kishte vijuar me njoftimin e fituesit brenda afateve normale, veprim që nuk e ka kryer brenda afateve ligjore të sipërcituara ose të vijonte me kërkesën për dorëzim dokumentacion provues operatorëve ekonomik të kualifikuar të radhës duke qenë se OE e kishte të pamundur dorëzimin e dokumentacionit provues brenda afateve të kërkuara duke e favorizuar.*

*Në rast të paprecedent Autoriteti Kontraktor pas kërkesës së marrë në SPE nga OE Star Trade Albania me tekstin "Përshëndetje ju njoftoj nga kompania Star Trade Albania që administratori jonë nuk mund të paraqitet deri ditën e enjte dt. 14.12.2023 pranë autoritetit tuaj kontraktues. Ju falënderojmë në qoftë se e merrni kërkesën tonë parasysht" AK në datë 12.12.2023 I kthen përgjigje se e pranon kërkesën "Përshëndetje. Po e marrim parasysht kërkesën tuaj por duhet ti sillni dokumentet ne date 14.12.2023. Pune te mbare." pra se e pranon kërkesën duke cenuar kështu barazinë në procedurë prokurimi dhe mbi të gjitha kemi pasur zvarritje të procesit të zhvillimit të procedurës. Me veprimet apo mosveprimet bazuar në legjislacionin e prokurimit publik AK ka favorizuar ofertuesin OE Star Trade Albania.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesave dhe KPP të verifikojë veprimet e sipërpërmendura në SPE. Edhe njëherë kërkojmë hapjen e fazës së rivlerësimit dhe të kryeni të gjitha hapat e procedurës së rregullt ligjore bazuar në ligjin e prokurimit publik nr. 162 date 23.12.2020, dhe VKM-se nr. date 19.05.2021, e ndryshuar duke na ofruar mundësinë e dorëzimit të dokumentacionit tonë provues sikundër kemi deklaruar si dhe të skualifikohet oferta ekonomike e OE Star Trade Albania pasi janë zgjatur afatet dorëzimit të dokumentacionit provues si dhe është tejzgjatur afati i publikimit të njoftimit të fituesit.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 3160/2 datë 21.12.2023.

II.7. Në datën 26.12.2023, protokolluar me tonën me nr.3160/3 prot., datë 26.12.2023, operatori ekonomik "Star Trade Albania" SHPK, në cilësinë e subjektit të interesuar, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

II.8. Me shkresën nr. 10 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr.3160/4, datë 09.01.2024, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin

e KSHA-së në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Bregu Comapany” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit.

II.9. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Bregu Company” SHPK duke argumentuar: “ ... Më datë 07.12.2023 është bërë renditja e fituesit në SPE dhe i është kërkuar operatorit fitues Star Trade Albania ShPK dorëzimi i dokumentacionit fizik më datë 11.12.2023. Në bazë të kërkesës së bërë për shtyrje afati deri më datë 14.12.2023, Autoriteti Kontraktor e ka pranuar kërkesën bazuar në VKM 285 datë 19.05.2023 neni 26 pika 6 'Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin", duke mos përmendur afat, dhe për rrjedhojë AK ka vendosur ta pranojë, gjithashtu oferta e operatorit ekonomik "Star Trade Albania" ShPK rezulton 116,120 lekë më e ulët se oferta e operatorit të renditur i dyti, duke u klasifikuar ekonomikisht më e favorshme. Operatori ekonomik "Star Trade Albania" ShPK e ka dorëzuar dokumentacionin fizik më datë 14.12.2023, brenda afatit 5 ditë pune duke qenë se data 08.12.2022 e premte ishte ditë feste. Më datë 15.12.2023 është dërguar për publikim Njoftimi I Fituesit Paraprak në SPE dhe është refuzuar me arsye "Unifikoni emrin e OE fitues në çdo sesion të formularit" Më datë 18.12.2023 është dërguar Njoftimi i fituesit paraprak për publikim në SPE dhe është publikuar më datë 19.12.2023.

*Sa më sipër pretendimi i O.E. ankimues "Bregu Company" SHPK nuk qëndron."*

II.10. Me shkresën nr. 3160/5 prot., datë 12.01.2024, me objekt “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, duke kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “ [...] informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe gjithë korrespondencën e mbajtur mes autoritetit tuaj kontraktor dhe operatorit ekonomik “Star Trade Company” SHPK për dorëzimin e dokumentacionit në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.”

II.11. Me shkresën nr. 40/1 prot., datë 17.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 3160/6 prot., datë 19.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Bregu Company” SHPK. Bashkëngjitur kësaj shkrese, autoriteti kontraktor ka dërguar: *Procesverbal i hapjes, mbylljes, raporti përfundimtar të KVO; kërkesë për dokumentacion nga KVO; kërkesë për shtyrje afati për dorëzimin e dokumentacionit nga ana e operatorit ekonomik “Star Trade Company” SHPK; raporti i kontrollit të dokumentacionit.*

II.12. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 07.12.2023, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të

kërkesës “Kërkesë për dokumentacion”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Star Trade Albania” SHPK ku citon: “Nga vlerësimi i procedurës së prokurimit me objekt: “SEKTORI I PASTRIMIT, UNIFORMA”, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, me fond limit : 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë ) Lekë Pa TVSH. nga Buxheti i Bashkisë Vlorë me Nr. REF-88061-11-17-2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar vlerësimin në sistem në datë 07/12/2023, nga ku rezultoi se nga dokumentacioni i paraqitur dhe oferta ekonomike, STAR TRADE ALBANIA ShPK është kualifikuar dhe renditur i pari. Në zbatim të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lutemi që të paraqisni dokumentacionin fizik pranë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike brenda datës 11.12.2023. Punë të mbarë!”

II.13. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se operatori ekonomik “Star Trade Albania” SHPK në datën 12.12.2023, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “Njoftim”, ka njoftuar autoritetin kontraktor duke cituar: “Përshëndetje ju njoftoj nga kompania Star Trade Albania që administratori jonë nuk mund të paraqitet deri ditën e enjte dt 14.12.2023 pranë autoritetit tuaj kontraktues. Ju falenderojmë në qoftë se e merrni kërkesën tonë parasysht”.

II.14. Gjithashtu, nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi konstatohet, se autoriteti kontraktor në datën 12.12.2023, në rubrikën “Përgjigje”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Star Trade Albania” SHPK ku citon: “Përshëndetje. Po e marrim parasysht kërkesën tuaj, por duhet t’i sillni dokumentet ne date 14.12.2023. Pune te mbare”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

#### Arsyeton:

III. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Bregu Company” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Star Trade Albania” SHPK me arsyetimin se: “[...] Edhe njëherë kërkojmë hapjen e fazës së rivlerësimit dhe te kryeni te gjitha hapat e procedurës se rregullt ligjore bazuar ne ligjin e prokurimit publik nr. 162 date 23.12.2020, dhe VKM-se nr. 285 date 19.05.2021, e ndryshuar duke na ofruar mundësinë e dorëzimit të dokumentacionit tonë provues sikundër kemi deklaruar si dhe të skualifikohet oferta ekonomike e OE Star Trade Albania, pasi janë zgjatur afatet e dorëzimit të dokumentacionit provues, si dhe është tejzgjatur afati i publikimit të njoftimit të fituesit [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.Në datë 30.11.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 07.12.2023, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

1. “Star Trade Albania” SHPK	1,767,600	lekë	kualifikuar
2. “Bregu Company” SHPK	1,883,720	lekë	kualifikuar
3. “Univers Promotion” SHPK	1,887,900	lekë	kualifikuar
4. “Biotek” SHPK	1,936,250	lekë	kualifikuar
5. “AMEL-E.Z” SHPK	1,995,540	lekë	kualifikuar
6. “Blerina Sadiku” SHPK	1,999,490	lekë	kualifikuar
7. “Bajro Bros” SHPK	1,999,490	lekë	kualifikuar
8. “ARTEO 2018” SHPK	2,095,670	lekë	kualifikuar
9. “Malvina Visoka” SHPK	2,226,800	lekë	kualifikuar
10. “Optima Communication” SHPK	2,400,000	lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 19.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.4 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit publik, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimit publik në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “Kërkesë për dokumentacion”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Star Trade Albania” SHPK për dorëzimin e dokumentacionit, ku citon: “Nga vlerësimi i procedurës së prokurimit me objekt: : “SEKTORI I PASTRIMIT, UNIFORMA”, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, me fond limit : 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë ) Lekë Pa TVSH. nga Buxheti i Bashkisë Vlorë me Nr. REF-88061-11-17-2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar vlerësimin në sistem në datë 07/12/2023, nga ku rezultoi se nga dokumentacioni i paraqitur dhe oferta ekonomike, STAR TRADE ALBANIA ShPK është kualifikuar dhe renditur i pari. Në zbatim të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lutemi që të paraqisni dokumentacionin fizik pranë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike brenda datës 11.12.2023. Punë të mbarë!”

Të njëjtin njoftim në formë shkresore, autoriteti kontraktor ia ka dërguar operatorit ekonomik “Star Trade Albania” SHPK, edhe përmes shkresës nr.513/11 prot., datë 07.12.2023.

III.5. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor konstatohet, se operatori ekonomik “Star Trade Albania” SHPK në datën 12.12.2023, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “Njoftim”, ka njoftuar autoritetin kontraktor duke cituar: “Përshëndetje ju njoftoj nga kompania “Star Trade

*Albania”, që administratori jonë nuk mund të paraqitet deri ditën e enjte dt. 14.12.2023 pranë autoritetit tuaj kontraktues. Ju falenderojmë në qoftë se e merrni kërkesën tonë parasysht”.*

III.6. Gjithashtu, nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 12.12.2023, në rubrikën “Përgjigje”, ka njoftuar operatorin ekonomik “*Star Trade Albania*” SHPK, ku citon: “*Përshëndetje! Po e marrim parasysht kërkesën tuaj, por duhet t’i sillni dokumentet në datën 14.12.2023. Punë të mbarë*”.

III.7. Referuar sistemit të prokurimit elektronik, në datën 19.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.8. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.8.1. Neni 24, pika 1, “*Komisioni i prokurimit Publik*” i Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon se: “*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij*”.



III.8.2 Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.8.3 Në nenin 26, pika 6, paragrafi i parë i VKM - së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

III.8.4. Në nenin 32, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.”*

III.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se afatet e kryerjes së veprimeve procedurale caktohen nga Kodi i Procedurës ose nga ligje të veçanta. Kohëzgjatja në të cilin një akt procedural duhet të realizohet, shprehet sipas rastit në ditë, muaj apo vite. Akti nënligjor për rregullat e prokurimit publik, konkretisht, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, afatin e publikimit të njoftimit të fituesit për një procedurë prokurimi e ka llogaritur në ditë dhe konkretisht duke i vendosur një afat maksimal jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave. Nga ana tjetër, referuar bazës ligjore të sipërcituar në rastet e procedurave të prokurimit me operatorë ekonomikë të kualifikuar si oferta të suksesshme, autoriteti /enti kontraktor ka detyrimin ligjor që përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike sipas parashikimeve të nenit 26/6 paragrafi i parë të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, çka nënkupton, se brenda kësaj periudhe kohore (menjëherë pas përfundimit të vlerësimit, por jo më vonë se 5 ditë), autoriteti kontraktor duhet

të komunikojë me ofertuesin për dorëzimin e dokumentacionit dhe vlerësimin e tij me qëllim që nëse përmbushen kushtet të vijohet me publikimin e njoftimit të fituesit.

Në rastin konkret, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Star Trade Albania” SHPK “*pasi janë zgjatur afatet e dorëzimit të dokumentacionit provues si dhe është tejzgjatur afati i publikimit të njoftimit të fituesit,*”, qëndron, pasi referuar dispozitave ligjore në fuqi menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor për publikimin e njoftimit të fituesit. Nga ana tjetër, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese dhe ato të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, me qëllim verifikimin e tyre dhe publikimin e njoftimit të fituesit. Në këtë kuptim, operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet që maksimalisht brenda 5 ditësh nga momenti i përfundimit të vlerësimit të ofertave, të dorëzojë në autoritet kontraktor dokumentacionin e kërkuar dhe mbi bazën e vlerësimit të kryer nëse plotësohen kushtet, autoriteti të procedojë me hapat e mëtejshme procedurale, siç është publikimi i njoftimit të fituesit.

Në rastin konkret, rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 07.12.2023 ka njoftuar operatorin ekonomik të renditur në vend të parë “Star Trade Albania” SHPK, për të dorëzuar dokumentet brenda datës 11.12.2023. Rezulton, se operatori ekonomik “Star Trade Albania”, nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se operatori ekonomik “Star Trade Albania” SHPK në datën 12.12.2023, (tejt afatit të përcaktuar për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar datë 11.12.2023), t’i ketë kërkuar autoritetit kontraktor zgjatjen e afatit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka miratuar kërkesën e operatorit ekonomik, të paraqitur jashtë afatit të përcaktuar (12.12.2023), për shtyrjen e datës së dorëzimit të dokumentacionit, duke i lënë një afat të ri (14.12.2023).

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe njoftimi i fituesit brenda afateve të përcaktuara ligjore, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis LPP*, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor me miratimin e kërkesës së operatorit ekonomik të paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar, ka sjellë pabarazi në rrethin e ofertuesve për këtë procedurë prokurimi. Në rastin konkret, KPP vlerëson, se veprimi i mësipërm ka shkelur një ndër parimet e mësipërme, atë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, parim i cili është një parakusht *sine qua non* i realizimit të objektit dhe

qëllimit të vetë ligjit për prokurimin publik, atë të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë, si edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte pasur parasysh parashikimet ligjore e konkretisht, nenin 2 dhe nenin 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në këto kushte, KPP gjykon, se vendimi i autoritetit kontraktor për pranimin e kërkesës së operatorit ekonomik të paraqitur jashtë afatit ligjor, për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga operatori i renditur në vend të parë, ka shkaktuar pabarazi në vlerësimin e ofertuesve për këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.10. Gjithashtu, KPP gjykon, se miratimi i kërkesës së paraqitur jashtë afatit ligjor, nga operatori ekonomik “Star Trade Albania” SHPK për shtyrjen e datës së dorëzimit të dokumenteve provuese dhe ato të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik me qëllim verifikimin e tyre dhe publikimin e njoftimit të fituesit, është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore aktualisht në fuqi dhe se zyrtari/ët përgjegjës të këtij autoriteti kontraktor kanë kryer shkelje të rregullave të prokurimit publik. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte refuzuar kërkesën e operatorit ekonomik “Star Trade Albania” SHPK, si kërkesë të paraqitur jashtë afatit ligjor. KPP këtë veprim/vendim të autoritetit kontraktor e gjen jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së.

III.11. Lidhur me evidentimin e kryer nga ana jonë në procedurën e prokurimit të sipërcituar, ku autoriteti kontraktor ka kryer shkelje të ligjit dhe rregullave të prokurimit, si dhe parimeve kryesore mbi bazën e të cilave është hartuar ligji për prokurimin publik, referuar çështjes së mësipërme, KPP gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik, për nisjen e hetimit administrativ kundrejt Autoritetit Kontraktor, bazuar në nenin 23, të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-88061-11-17-2023, me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Star Trade Albania” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

